

BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[15.10.2024]

Drejtuar:

“SULLOLLARI-KLIMA” SH.P.K

TIRANE Rruga "Muhamet Gjollësia 71/3, Kati 1

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-20706-09-19-2024, Blerje Kondicioner

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.63, Datë 23 Shtator 2024;

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Comfort” shpk**NUIS J61901194M**

Vlera e ofertës pa tvsh- 1,199,000 një milion e njëqind e nëntedhejetë e nënte mijë lekë;

Vlera e ofertës me tvsh– 1,438,800 një milion e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind lekë;

2. Operatori ekonomik “Budiag Klima” shpk**NUIS L71509032C**

Vlera e ofertës pa tvsh– 1,203,000 një milion e dyqind e tre mijë lekë;

Vlera e ofertës me tvsh– 1,443,600 një million e katërqind e dyzetë e tre mijë e gjashtëqind lekë;

3. Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” shpk**NUIS K01529003M**

Vlera e ofertës pa tvsh– 1,562,431.5 një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e Katërqind e tridhjetë e një pikë pesë lekë;

Vlera e ofertës me tvsh– 1,874,917.8 një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tetë lekë;

4. Operatori ekonomik “Bajro Bros” shpk

NUIS M113130290

Vlera e ofertës pa tvsh– 1,562,432 një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e dy lekë;

Vlera e ofertës me tvsh– 1,874,918.4 një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë pike katër lekë;

5. Operatori ekonomik “Laviva Technologies” shpk

NUIS M01323012A

Vlera e ofertës pa tvsh– 1,562,432 një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e dy lekë;

Vlera e ofertës me tvsh– 1,874,918.4 një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë pike katër lekë;

6. Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” shpk

NUIS M31904013D

Vlera e ofertës pa tvsh– 2,070,000 dy milion e shtatëdhjetë mijë lekë;

Vlera e ofertës me tvsh– 2,484,000 dy milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë lekë;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Comfort” shpk

NUIS J61901194M

Vlera e ofertës pa tvsh- 1,199,000 një milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë lekë;

Vlera e ofertës me tvsh– 1,438,800 një milion e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind lekë;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit **nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar)**, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik “COMFORT” shpk, nga ku rezultoi se:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën A) Pjesa II, të Shtojcës 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, specifikisht pjesën si më poshtë:

“Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Rezart Stermasi Deshmi Penaliteti etj. nuk janë të

dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.”

Referuar sa më sipër, operatori ekonomik duhet të deklaronte gjithashtu ortakët, ose cdo person tjetër që ka kompetenca vendimarrëse brenda tij. Në Ekstratin e thjeshtë të OE, rezulton se përvec , administratorit dhe ortakut, Rezart Stërmasi, i deklaruar në Shtojcën 8, OE ka dhe një ortak tjetër me 50% të aksioneve, Z. Luftulla Stërmasi, i cili gjithashtu duhej të ishte deklaruar nga ana e OE. Në referencë të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), pika 1 dhe 2 e këtij neni, kërkohet:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla....”. Operatori ekonomik nuk i është përmbajtur plotësisht në mënyrë të saktë të gjithë informacionit që kërkohet në shtojcën 8, në mënyrë që autoriteti kontraktor të njohë gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar pikën 2.3.2 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Dokumentat Standarte të Tenderit, ku citohet si vijon: “Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se dokumenti i paraqitur me emërtimin “*Autorizimi i prodhuesit italisht-shqip.pdf*”, nuk është i noterizuar dhe i përkthyer në mënyrë zyrtare nga një noter, duke mos qenë në përputhje me kërkesat e DST: **të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim.**

3. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar pikën 2.3.4 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Dokumentat Standarte të Tenderit, ku citohet si vijon: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshura për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre)”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se dokumentat e paraqitur referuar përmbushjes së kësaj pike

nga OE, me emërtimet përkatësisht “Katalogu kolone BT.pdf” dhe “Katalogu BT. Pdf” janë në gjuhën italiane. Referuar DST, Seksioni 1 Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika 2 B) **“Gjuha e ofertës”** citohet se : *“Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim”*. Rezulton se të dy materialet e sipërpërmendura që i referohen dorëzimit të katalogëve mbi mallin objekt prokurimi janë të papërkthyer në gjuhën shqipe, e cila është gjuha e vendosur në dokumentat e tenderit për dorëzimin e ofertës.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik “COMFORT” SHPK, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë te pavlefshme.

2. Operatori ekonomik “Budiag Klima” shpk

NUIS L71509032C

Vlera e ofertës pa tvsh– 1,203,000 një milion e dyqind e tre mijë;

Vlera e ofertës me tvsh– 1,443,600 një million e katërqind e dyzetë e tre mijë e gjashtëqind;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi se :

Operatori ekonomik nuk plotëson Shtojcën 1 – Formulari i Ofertes dhe Shtojcën 2 - Lista e cmimeve të artikujve sipas formatit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor në DST, pasi nga verifikimi i shtojcës 1 dhe 2 të paraqitura nga ky operator vihet re se nuk i është përmbajtur formatit standart, duke qenë se ka bashkuar pjesë të të dyja shtojcave në një dokument të vetëm, të emërtuar “Formulari i ofertes ekonomike”.

Referuar DST, Udhëzime për Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. PËRGATITJA E OFERTAVE, nën-pika 4 Formularët e tenderit dhe Listat Çmimesh, citohet shprehimisht: 4. **Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.**

Gjithashtu referuar VKM-se Nr. 285/2021 i ndryshuar, neni 82, pika 2, i) dhe iii) si më poshtë citohet: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit; ii.; dhe iii. “Mospranimi” është*

mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit". Operatori ekonomik referuar Shtojcave të sipercituara ndodhet në të kundërt sipas VKM-se dhe si rrjedhim oferta konsiderohet e pavlefshme.

2. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar pikën 2.3.2 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Dokumentat Standarte të Tenderit, ku citohet si vijon: "*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij*". Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se dokumenti i paraqitur me emërtimin "**Authorization Letter Budiag 2024.pdf**" nuk është i noterizuar dhe i përkthyer në mënyrë zyrtare nga një noter, duke mos qenë në përputhje me kërkesat e DST: **të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim.**

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik "BUDIAG CLIMA" SHPK, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**SULLOLLARI-KLIMA shpk**, me adresë në TIRANE Rruga "Muhamet Gjollësia 71/3, Kati 1], se oferta e paraqitur me vlerë 1,562,431.5 një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e një pikë pesë lekë pa tvsh dhe 1,874,917.8 një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tetë lekë me tvsh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".